



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 9.4.2024

Nr: 34

Ora: 12:00

**VENDIM
PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KRUIJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SË GJELBËR”, ZJ.
MERI IDAJET ZALLA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 987 prot., datë 15.02.2024, Këshilli i Bashkisë Krujë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Isuf Afmet Baku, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia e Gjelbër”.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmeore e Partisë së Gjelbër, për Këshillin e Bashkisë Krujë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Meri Idajet Zalla.

Me shkresën nr. 489, prot., datë 21.02.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Krujë, zj. Meri Idajet Zalla, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmeore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmeore, të subjektit Partia Gjelbër, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DR-P.GJ-22860_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Data: 9.4.2024 Nr: 34
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë me kandidatin nga lista shumëmeore e “Partisë së Gjelbër”, zj. Meri Idajet Zalla.”

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Meri Idajet Zalla, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 636 prot., datë 04.03.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 635 prot., datë 04.03.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Meri Idajet Zalla.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 2960/1 prot., datë 21.3.2024 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Meri Idajet Zalla, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjëndjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3499/1 prot., datë 07.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Meri Idajet Zalla, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Meri Idajet Zalla, në Këshillin e Bashkisë Krujë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Gjellbër, zj. Meri Idajet Zalla.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI